

UDHËZUES PËR
PARAQITJEN E ANKESAVE
GJATË PROCESIT TË
AVANCIMEVE AKADEMIKE
NË UNIVERSITETIN E
PRISHTINËS

Prishtinë, qershor 2018

Publikues:

ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8, 10000 Prishtina, Kosova

Autore: Rina Kika

Prishtinë, qershor 2018

HYRJE

Ky udhëzues vjen pas 1 viti e gjysmë aktivitetesh të ORCA-s të përqendruara në çështjen e integritetit akademik. ORCA arriti që ta tematizojë çështjen e integritetit të revistave ku kanë publikuar profesorët e Universitetit të Prishtinës sidomos pas suksesit të vitit 2017 në procesin e avancimeve akademike.

Gjatë vitit 2017 ORCA monitoroi përmes një roli proaktiv procesin e avancimeve akademike ku u arrit që 70 raste të avancimeve jomeritore të mos realizoheshin ndonëse kishin marrë rekomandime pozitive nga komisionet vlerësuese. ORCA ofroi analizat dhe hulumtimet e saj te senatorët e Senatit të UP-së të cilët, bashkë me menaxhmentin, ndonëse në heshtje, i kanë shfrytëzuar si ndihmë për punën e tyre.

Situata e re e krijuar ka rezultuar me angazhimin e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë duke nxjerrë Udhëzimin Administrativ 1/2018 dhe së fundmi Udhëzimin Administrativ 7/2018 të cilët qartësojnë mjaftueshëm, por jo kënaqshëm, llojin e platformave indeksuese për revistat që do të merren parasysh për avancime akademike në Republikën e Kosovës.

Kjo poashtu ka nxitur hartimin e një rregullore nga ana e UP-së e cila mundohet ta rregullojë më në detaje, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 1/2018 çështjen e revistave ndërkombëtare që merren

parasysh për avancime akademike në UP.

Ky udhëzues vjen me qëllim të informimit të kandidatëve për procedurat e përcaktuara sipas rregullativës në fuqi. Vjen si pjesë e monitorimit nga ana e ORCA-s për procesin e avancimeve akademike 2018/2019 dhe si mjet brenda paketës së ORCA-s për ndihmë juridike kandidatëve të pakënaqur me vlerësimet, vendimet apo zbatimin e procedurave të procesit.

Rron Gjinovci

PROCESI I AVANCIMEVE AKADEMIKE 2018/2019

Suksesi i vitit të kaluar dhe precizimi në dokumentet rregullative, nuk duken të qëndrueshme pasur parasysh tendencën e vazhdueshme për kontestim të parimeve të integritetit akademik apo edhe dokumenteve të përmendura nga ana e profesorëve të UP-së, sidomos kur kemi parasysh se 72% e tyre nuk i justifikojnë titujt e tyre akademik. Çka do të thotë se 72% e profesorëve nuk kanë numër të mjaftueshëm të punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare për t'i merituar titujt akademik.

Për këto arsye ORCA ka vendosur që ta monitorojë edhe procesin e avancimeve akademike të vitit 2018 në Universitetin e Prishtinës, me një trupë më të fortë hulumtuesish e sidomos mbi bazat e një strukture më të favorshme institucionale e rregullative.

Përveç anës përmbajtësore lidhur me integritetin akademik të revistave për të cilën ORCA do të hulumtojë dhe ndajë me publikun informacione të nevojshme, këtë vit ORCA ka arritur të krijojë një ekip ligjor në kuadër të zyrës së saj i cili do të ofrojë këshillim dhe mbështetje ligjore për palët që kanë pretendime të bazuara për shkelje të rregullativës në fuqi si në procedurë ashtu edhe në përmbajtje.

Qëllimet e ORCA-s lidhur me këtë proces të avancimeve akademike në UP janë:

1. Krijimi i një tradite të avancimeve meritore në Universitetin e Prishtinës.
2. Fuqizimi i palëve pjesëmarrëse në proces për ta arritur një nivel të kënaqshëm të meritokracisë.
3. Kthimi i besimit të publikut në procese të tilla me qëllim sigurimin e një konkurrence të mirëfilltë vetërregulluese në të ardhmen.

DOKUMENTET RREGULLUESE TË PROCESIT

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë procesin e avancimeve akademike janë:

1. Ligji Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Kosovë,
 2. Statuti i Universitetit të Prishtinës,
 3. Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative
 4. Ligji Nr.2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë
 5. Ligji Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative
 6. Kodi i Etikës i stafit akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Nr. 1/751, i datës 19.07.2013
 7. Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.01/2018, Parimet e Njohjes së Platformës dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension,
 8. Udhëzimi Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (Aneksi –I-MASHT) Nr.07/2018 e UA Nr.01/2018 Parimet e njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension,
 9. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik,
 10. Rregullorja Nr. 465 për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik në Universitetin e Prishtinës
 11. Udhëzuesi nr.1/210 për Standardet dhe Parimet Etike të Universitetit të Prishtinës në lidhje me Shmangien e Nepotizmit dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Procedurat e Zgjedhjes së Stafit Akademik
-

FRYMA E DOKUMENTEVE RREGULLUESE - PARIMET E PËRGJITHSHME TË TRANSPARENCËS DHE INTEGRITETIT AKADEMIK NË PROCESIN E AVANCIMEVE AKADEMIKE

ORCA konsideron se dokumentet rregulluese të procesit të avancimeve akademike gjithnjë duhet të lexohen në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, në favor të rritjes së integritetit akademik, në favor të maksimizimit të lirisë akademike, sipas frymës së Procesit të Bolonjës, standardeve evropiane dhe aspiratave të shoqërisë sonë për zhvillim e prosperitet.

ORCA përpiket për një rritje standardesh akademike të cilat lidhen ngushtë me vlerësimin nga komisionet vlerësuese si hallka e parë e procesit të avancimeve.

Në këtë kontekst ORCA ka arritur të listojë disa obligime që burojnë nga fryma e dokumenteve rregulluese e të cilat do të duhej të ndiqeshin nga të gjitha palët e përfshira në proces.

TRANSPARENCA

Të gjitha organet publike, duke përfshirë këtu edhe Universitetin, e kanë për obligim të veprojnë me transparencë. Ky obligim është përherë i pranishëm në legjislacionin në fuqi dhe rrjedhë nga rregullativa të ndryshme.

Neni 9 i Ligjit për Procedurën Administrative përcakton se organet publike duhet të veprojnë me transparencë. Ndërkaq, sipas nenit 173, paragrafi 4 i Statutit të Universitetit të Prishtinës përcaktohet se procedurat për emërim të stafit akademik bëhen në mënyrë transparente me shpalljen e konkursit publik.

Komisionet vlerësuese duhet ta pasqyrojnë në tërësi punën e kandidatëve dhe të mos jenë selektiv ashtu që t'i maksimizojnë shanset e të gjithë kandidatëve të paraqitur për vlerësim sa më objektiv.

Komisionet vlerësuese nuk duhet të komentojnë për kontributet historike, morale a të tilla të kategorive subjektive kur vlerësojnë kandidatët për punën e tyre shkencore dhe aftësitë e tyre akademike. Vlerësimi i komisioneve vlerësuese duhet të jetë objektiv, i matshëm dhe i qartë për publikun.

Komisionet vlerësuese duhet të jenë të qarta në rekomandimet e tyre për propozimin për zgjedhje apo avancim dhe ta arsyetojnë propozimin me argumente objektive.

Përveç organeve të universitetit, edhe kandidatët duhet të tregohen transparent gjatë procesit dhe në rastet kur paraqesin punën e tyre duhet të kujdesen që puna e tyre e paraqitur në publik apo pranë komisioneve vlerësuese të jetë lehtë e identifikueshme dhe e qartë për palët e interesuara si për nga autorësia po ashtu për nga lloji i punës.

SHMANGIA NGA KONFLIKTI I INTERESIT

Anëtarët e komisioneve vlerësuese duhet të veprojnë në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Udhëzuesin nr.1/210 për Standardet dhe Parimet Etike të Universitetit të Prishtinës në lidhje me Shmangien e Nepotizmit dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Procedurat e Zgjedhjes së Stafit Akademik të nxjerrë më 2 maj 2018 nga Këshilli i Etikës të Universitetit të Prishtinës.

Anëtarët e komisioneve vlerësuese të cilët janë bashkautor me kandidatët nuk duhet të jenë pjesë e vlerësimit.

Kandidatët apo anëtarët e komisioneve vlerësuese nuk duhet të kenë lidhje familjare apo të tjera që konsiderohen konflikt i interesit sipas rregullativës së zbatueshme në Kosovë.

MERITOKRACIA

Komisionet vlerësuese duhet t'i respektojnë në përpikmëri dokumentet rregulluese dhe frymën e tyre, andaj edhe mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportet që ato i përgatisin si dhe për rekomandimet që i japin.¹

Komisionet vlerësuese duhet të japin arsye të forta objektive për përcaktimin për një kandidat në rastet kur propozojnë të tillë për zgjedhje apo avancim.

Gradat më të larta shkencore duhet të kenë përparësi ndaj gradave më të ulëta shkencore.

HAPAT E PROCESIT TË AVANCIMEVE AKADEMIKE - VLERËSIMIT DHE MUNDËSITË E ANKIMIMIT

HAPAT E PROCESIT BRENDA UP-SË – MUNDËSITË E ANKIMIMIT

1. Konkursi publik

Procesi i avancimeve akademike në Universitetin e Prishtinës ka filluar zyrtarisht me hapjen e konkursit me datën 27 prill 2018 dhe me aplikimin e palëve. Pas mbylljes së konkursit më datë 14 maj 2018 ka filluar vlerësimi nga komisionet vlerësuese të cilat i shkruajnë raportet e tyre.

2. Komisionet vlerësuese dhe ankuese

Komisionet vlerësuese caktohen nga këshilli i fakultetit 10 ditë pas hapjes së konkursit dhe përbëhen nga 3 anëtarë të cilët propozohen nga radhët e profesorëve të degës dhe duhet të kenë thirrje të lartë akademike ose së paku të njëjtë me pozitën për të cilën është hapur konkursi.² Komisionet vlerësuese mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe janë të obliguar që t'i respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe mund të sanksionohen për rekomandimet që i bëjnë sipas Kodit të Etikës së Universitetit të Prishtinës dhe në bazë të akteve tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.³ Fakulteti i emëron edhe komisionet e ankesave, anëtarët e së cilave nuk mund të jenë në strukturat udhëheqëse të fakultetit dhe departamentet përkatëse apo anëtarë të komisioneve vlerësuese.⁴

3. Raportet vlerësuese

Komisionet duhet të hartojnë dhe dorëzojnë raportet e tyre vlerësuese për kandidatët të cilët kanë aplikuar në pozitën e caktuar brenda 15 ditëve pas mbylljes së konkursit.⁵ Raportet e komisioneve vlerësuese nënshkruhen nga të tre anëtarët e komisionit vlerësues dhe i dorëzohen Këshillit të Fakultetit.⁶

Në raportet vlerësuese bëhet propozimi i qartë i komisionit vlerësues për emërim, riemërim ose avancim të kandidatëve.⁷ Komisioni vlerësues duhet t'i japë përparësi kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe që janë më të mirë në krahasim me kandidatët tjerë sa i përket aktivitetit

të tyre shkencor/artistik, profesional dhe akademik.⁸ Në raport vlerësues duhet të shkruhen edhe kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet minimale por që nuk janë propozuar të emërohen.⁹ Në raste të tilla komisioni vlerësues duhet t'i cekë kushtet që nuk janë plotësuar.¹⁰

4. Publikimi i Buletineve

Këshilli i fakultetit organizon takim për shqyrtimin e raporteve vlerësuese dhe i publikon ato në web faqen e Universitetit në formë të buletineve.¹¹ Këto buletine qëndrojnë të publikuara për 15 ditë.

5. Ankesa ndaj Raporteve Vlerësuese

Pas publikimit të Buletineve në faqen e universitetit kandidatët e pakënaqur me raportet e komisioneve vlerësuese mund të ushtrojnë ankese pranë këshillit të fakultetit përkatës.¹² Është shumë e rëndësishme që raportet e komisioneve vlerësuese të jenë të sakta dhe të pasqyrojnë vlerësimin e mirëfilltë të arritjeve shkencore/artistike, profesionale e akademike të kandidatëve. Në qoftë se ju keni përvojë më të gjatë pune, ndërsa u janë numëruar më pak vite përvojë pune, atëherë ushtrojeni të drejtën për ankese. E njëjta vlen për të gjitha kualifikimet tjera të cilat i përmban raporti vlerësues e që nuk i pasqyrojnë kualifikimet tuaja. Keni parasysht se këto raporte janë dokumentet që merren parasysht për marrjen e vendimit për avancim akademik, andaj ju duhet të siguroheni që raportet të paraqesin një pasqyrim të saktë të arritjeve dhe kualifikimeve tuaja.

Ankesat dorëzohen në administratën e Këshillit të Fakultetit.¹³

- Ankesa duhet të adresojë në mënyrë të qartë shkeljet procedurale, gabimi i zbatimit të rregullativave apo gabimet në vlerësim të arritjeve tuaja që janë evidentuar në raportet vlerësuese. Ankesa duhet t'i ketë kërkesat të qarta në fund:
 - a. të kërkojë aprovimin e ankesës si të bazuar
 - b. të kërkojë ndryshimin e vlerësimit në raportin vlerësues apo
 - c. të kërkojë anulimin e vlerësimit në raportin vlerësues

6. Vendimi për ankesat

Komisioni për ankesa i shqyrton ankesat dhe përpilon raport i cili i dorëzohet këshillit të fakultetit.¹⁴ Ky i fundit duhet ta shqyrtojë raportin e Komisionit për ankesa dhe vendosë në lidhje me ankesat për të cilat duhet të japë përgjigje me shkrim.¹⁵

Pas vendimit për ankesat dhe për raportet vlerësuese, këshilli i fakultetit përkatës raportet ia dërgon Zyrës për çështje akademike, e cila konstaton nëse ka ndonjë lëshim në materialin e dorëzuar dhe ka rol të kontrollimit teknik të lëndëve.¹⁶

Rektori themelon një komision këshillëdhënës i cili e shqyrton rregullsinë e procedurës dhe propozimeve të paraqitura nga Fakulteti dhe e këshillon rektorin në lidhje me propozimet nga fakulteti.¹⁷

7. Vendimi i Senatit

Senati merr vendim për secilën pozitë veç e veç. Varësisht nga vendimi i Senatit rastet mund të kthehen në këshillin e fakultetit për rishqyrtim apo të përfundojnë me përgjigje pozitive.¹⁸

Në rast të kthimit të rastit në këshillin e fakultetit përkatës, këshilli i fakultetit detyrohet të rishqyrtojë rastin dhe pas rivlerësimit të nxjerrë propozim të ri dhe t'ia dorëzojë Senatit.

Senati vendos përfundimisht për rastin.

8. Ankesa ndaj Vendimit të Senatit

Pala mund të ankohet pranë Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa në kuadër të Universitetit të Prishtinës si instanca përfundimtare brenda universitetit.

Afati për paraqitjen e ankesës është 15 ditë nga marrja e vendimit të Senatit.¹⁹

- Ankesa duhet të dorëzohet brenda afatit të ankesës, përndryshe do të hidhet poshtë si e pasafatshme dhe nuk do të shqyrtohet fare nga organi përkatës.²⁰ Ajo duhet të dorëzohet në administratën e universitetit gjatë orarit të punës, apo mund të dorëzohet edhe përmes postës duke iu drejtuar organit kompetent për shqyrtimin e ankesës.²¹ Në qoftë se ankesa dorëzohet përmes postës, atëherë duhet të dorëzohet përmes postës rekomandë (apo postës së regjistruar) dhe ta mbahet dëshmia e dërgesës postare si vërtetim se e keni dorëzuar ankesën brenda afatit të ankesës.²² Kandidatët gjithmonë duhet ta ruajnë një kopje të ankesës së plotë bashkë me dokumentet bashkëngjitëse për vete.
- Ankesa duhet të paraqesë qartë organin të cilit ajo i adresohet, vendimin të cili është duke e kontestuar dhe arsyetimin se përse vendimi është i paligjshëm. Në ankesë duhet të listohen pretendimet ankimore dhe të shpjegohen qartë arsyet se përse pretendohet se vendimi i marrë është i paligjshëm dhe i gabuar.

- Për shembull, në qoftë se kandidati konsideron se janë bërë shkelje sa i përket parimit të meritokracisë dhe se është zgjedhur një kandidat që ka qenë më i dobët, atëherë duhet të argumentohet në bazë të çfarë fakteve mund të dëshmohet ky pretendim.
- Bashkë me ankesën dorëzohen edhe dëshmi të cilat i mbështesin pretendimet si dhe përdoren referenca në materiale tjera të cilat i bëjnë argumentet e paraqitura më të fuqishme.
- Ankesat duhet të adresojë në mënyrë të qartë shkeljet procedurale, gabimin e zbatimit të rregullativave apo gabimet në vlerësim të arritjeve apo kualifikimeve të evidentuara në raportet vlerësuese.
- Ankesa duhet t'i ketë kërkesat e qarta në fund dhe duhet:
 - a. të kërkojë aprovimin e ankesës si të bazuar
 - b. të kërkojë ndryshimin vendimit pjesërisht apo plotësisht apo
 - c. të kërkojë anulimin vendimit

Nëse ankesa merret parasysh dhe Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa (KAP) udhëzon Senatin për shqyrtim të ankesës, Senati e shqyrton ankesën. Nëse ankesa hedhet poshtë si e pabazuar, pala mund të drejtohet te institucionet tjera relevante.

ANKIMIMI TE INSTITUCIONET TJERA

Kandidatët të cilët pretendojnë se ka pasur parregullsi gjatë procesit të konkurrimit për avancime akademike duhet që së pari t'i ndjekin procedurat e mësipërme të ankimit dhe më pas mund t'i drejtohen institucioneve tjera.

Pas shqyrtimit përfundimtar nga Senati siç u përshkrua më lartë, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Inspektoratit të Arsimit në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inspektoratit të Punës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me kërkesë për inspektim. Në qoftë se inspektoratet gjejnë shkelje atëherë mund ta kthejnë rastin në Senat që të rivlerësojë rastin dhe të vendosë edhe një herë.

Në rast se brenda afatit të përcaktuar nga inspektoratet Senati nuk merr vendim atëherë pala e dërgon vendimin e inspektorateve për përmbarim në gjykatë.

Përveç Inspektoratit për Arsim, Pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për konfliktin administrativ pranë gjykatës së shkallës së parë – Gjykata Themelore, Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë në përputhje me Ligjin Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative. Afati për paraqitjen e padisë për konfliktin administrativ është brenda 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit përfundimtar nga pala.²³

MBËSHTETJA NGA ORCA

ORCA do të mbajë takime informative me të gjitha palët ankuese ku do të ofrojë këshilla të përgjithshme në lidhje me parashtrimin e ankesave dhe do t'i adresojë pyetjet e përgjithshme të palëve ankimore.

Në rast se palët e pakënaqura duan ta kenë përcjelljen e ORCA-s përgjatë rrugëtimit të ankesës së tyre atëherë udhëzohen që ta paraqesin rastin në ankesa.orca@gmail.com me informatat dhe dokumentet e skanuara si vijon:

- Emri dhe mbiemri
- CV
- Pozita për të cilën keni aplikuar
- Fakulteti dhe departamenti (nëse ka)
- Raporti vlerësues si dhe numri i buletinit në të cilin është publikuar
- Një përshkrim i shkurtër i rrethanave të rastit dhe
- Ankesa e cila i liston shkeljet të cilat pretendoni se janë bërë gjatë procesit bashkë me argumentet që i mbështesin pretendimet ankimore

REFERENCAT

1. Neni 11, paragrafi 19 dhe paragrafi 25, Rregullorja Nr.465 për Procedurat Përzgjedhëse lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akadamik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" (në vazhdim «Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse»). Neni 11, paragrafi 1, 2 dhe 4, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
2. Neni 11, paragrafi 1, 2 dhe 4, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
3. Neni 11, paragrafi 18 dhe 25, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
4. Neni 11, paragrafi 2 dhe 3, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
5. Neni 11, paragrafi 15, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
6. Neni 11, paragrafi 22, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
7. Neni 11, paragrafi 20, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
8. Neni 11, paragrafi 19, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
9. Neni 11, paragrafi 21, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
10. Ibid.
11. Neni 12, paragrafi 2, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
12. Neni 12, paragrafi 6, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
13. Neni 12, paragrafi 7, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
14. Neni 12, paragrafi 9, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
15. Neni 12, paragrafi 9, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
16. Neni 12, paragrafi 11, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
17. Neni 13, paragrafi 1, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
18. Neni 13, paragrafi 4, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
19. Neni 14, paragrafi 3, Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse.
20. Neni 129, paragrafi 1.3, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (në vazhdim: „Ligji për Procedurën Administrative”).
21. Neni 74, paragrafi 6, neni 76, paragrafi 3, Ligji për Procedurën Administrative.
22. Neni neni 82 paragrafi 1.1, Ligji për Procedurën Administrative.

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupsionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbytja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.



www.orca.org